Kronikë

Qëlluan policinë shqiptare në kufirin Shiqipëri-Kosovë, 6 emigrantët e huaj 3 muaj në qeli! Avokatja: Ishin shtegtarë

Gjykata e Kukësit ka në masë arresti me burg për 3 muaj, 6 emigrantët e huaj nga vendjet e Lindjes, të cilët akuzohen se qëlluan ndaj policisë në kufirin Shqipëri-Kosovë në Morinë. Në mbrojtje të tyre u vu një avokate nga shteti, e cila tha se të arrestuarit kanë dashur vetëm të kalojnë kufirin e gjelbër për në vendet e BE, dhe se trafikantët e klandestinëve që qëlluan ndaj bluve, janë 3 persona të tjerë, gjithashtu të huaj.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
28 Maj, 14:16 | **Përditesimi: 28 Maj, 16:36**

Gjykata e Kukësit ka lënë në masën 'arrest me burg' për 3 muaj, ***6 emigrantët e huaj*** nga vendet e Lindjes, kohë e mjaftueshme kjo, sipas togave të zeza, që Prokuroria të marrë në dorë provat, nëse të arrestuarit, kanë qëlluar apo jo ndaj policisë në kufirin Shqipëri-Kosovë, të enjten.

Për mbrojtjen e tyre u caktua një avokate nga shtetit, e cila tha se trafikantët që qëlluan me armë ndaj forcave blu, nuk janë në mesin e 6 të arrestuarve, që sipas saj janë vetëm emigrantë që kaluan kufirin e gjelbër shqiptar për të arritur në vendet e BE-së për të punuar.

LEXO EDHE:
'Ish-ambasadorët' që kërkojnë të zbojnë SHBA nga Kosova

Sipas avokates Aurora Guska, 3 prej emigrantëve të huaj kishin ardhur për herë të parë në Shqipëri, ndërsa 3 të tjerë janë përsëritës në tentativën e tyre për të kaluar kufirin.

> *"Donin të ktheheshin në Greqi, 2 të dënuar në Kosovë, me 14 muaj, kishin mësuar dhe shqip. Kanë qenë 3 persona të tjerë, ata që kanë goditur mbi policinë ku të gjashtë së bashku personat që ndodheshin sot para gjykatës deklaruan se u është vënë pistoleta në kokë dhe u është marrë gjithcka kishin pasur në xhepa. Të gjashtë personat në sallën e gjyqit përmendin 3 emra, 2 algjerian dhe 1 palestinezë që unë për efekt hetimesh nuk mund t'jua them. Marokeni kishte kërkuar azil në Kosovë, ia kishin refuzuar", - tha avokatja Guaska.*

Të arrestuarit akuzohen se janë pjesë e një rrjeti trafikantësh të klandestinëve që qëlluan ndaj policisë e cila ndërhyri për të penguar lëvizjen e tyre nga Shqipëria drejt Kosovës.

Të arrestuar

Ayoub Bahhoo, 27 vjeç,

Muhaned Nasir, 25 vjeç,

Nagid Alabdahah, 20 vjeç,

Muhamed Shehab, 21 vjeç,

Mohamed Radaëin, 20 vjeç

Rabii Lqadi, 40 vjeç

Në kërkim

Sultan Grimashi, 27 vjeç, algjerian

AKUZAT

Vrasje ndaj policisë e mbetur në tentativë

Armëmbajtje pa leje

Kalim i paligjshëm i kufirit

M.Q./A.M./Shqiptarja.com

TAG: gjykata e kukesit | kosove | Kukes

Komente

Eri: 28/05/2023 18:05
Ata sujesnin per police imagjino sa te rrezikshem... I kemi pare mugeve te qytetave sa te rrezikshem e te dhunshem jane. Han pa Porta...duhen kthyer mbrapsh te gjithe se e qelbrn european...ata nuk punojne

Scutari: 28/05/2023 16:39
Shtegtarët mbajnë shkop me vete, jo pistoletë!!

Toni: 28/05/2023 15:41
Kalbini ne burg terroristet islamike.

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Tensionet në veri, si i vlerësoni vendimet e qeverisë së Kosovës?

Të drejta | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Ambasadorja Yuri Kim vizitë në Tropojë: Qyteti im më i pëlqyer në Shqipëri, më duket sikur jam me familjen time kur vij këtu
28 Maj, 17:01

Stoltenberg për situatën në veri të Kosovës: Prishtina mos të ndërmarrë hapa të njëanshëm dhe destabilizues
28 Maj, 16:35

Financial Times reportazh për Bajram Currin: Burrat largohen nga Shqipëria për të punuar, teksa gratë fitojnë liri të reja që nuk i gëzonin në komunizëm
28 Maj, 14:48

Sovranistët e Kosovës dhe Shqipërisë janë idiotë apo spiunë të Rusisë?
Kreshnik Spahiu
28 Maj, 14:35

Kurti: Marrëveshja me Serbinë duhet të zbatohet pa kushte
28 Maj, 13:04

Çifti nga Kosova lë biznesin dhe vendosin t'i rikthehen emigrimit, Altin Prenga kërkesë fisnike: Do ishte humbje për vendin të ikin, blijani të gjitha lulet (FOTO)
28 Maj, 10:28

Zhvillimet në veri të Kosovës, Kurti pret të dërguarin gjerman në Prishtinë: Respektuam rregullat! Vuçiç: S'dorëzohemi! Javën tjetër takohem me Macron dhe Shcolz
28 Maj, 10:03

Mero Baze: Albin Kurti sillet si i penduar për Marrëveshjen e Ohrit
Mero Baze
27 Maj, 19:04

Ish i dërguari amerikan, Grenell kritikon ashpër Kurtin: Rrënuat lidhjet e forta SHBA-Kosovë, të gjithë kundër jush! Kemi nevojë për Thaçin
27 Maj, 16:35

Lista Serbe i kërkon Vuçiç të ndërpresë dialogun me Kosovën derisa të largohet policia dhe kryetarët e komunave
27 Maj, 12:53

Ëndrra arabe e Albin Kurtit
Kimete Berisha
27 Maj, 11:16

Policia ruan ndërtesat komunale në veri të Kosovës, Osmani akuzon Beogradin: Po instrumentalizon serbët! Serbia në fuqi gatishmërinë luftarake
27 Maj, 07:39

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje